

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 2 (dy) vende pune pranë Institutit të Gjeoshkencave si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune “Kërkues Shkencor në fushën e Sizmologjisë Numerike” në Departamentin e Sizmologjisë, në Institutin e Gjeoshkencave duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

I. Kriteret e përgjithshme:

- Kandidati duhet të ketë përfunduar ciklin e studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave, ose ciklin e integruar të studimeve të larta, në fushën e Fizikës ose Inxhinierisë Fizike, me notë mesatare të përgjithshme të ponderuar jo më pak se 80/100, në përputhje me statutin e UPT.
- Kandidati duhet të dëshmojë njohjen e një gjuhe të huaj, preferuar një nga gjuhët zyrtare të vendeve anëtare të OECD-së (si anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht etj.), në një nivel funksional për komunikim akademik e shkencor (jo më pak se niveli B2 sipas CEFR; preferohet C1 ose më lart).

II. Kriteret specifike:

- Formim i avancuar në modelim numerik, përpunim të sinjaleve valore dhe të dhënave shkencore, ose në aplikime të fizikës teorike apo inxhinierike të lidhura me sistemet komplekse natyrore.
- Aftësi të dokumentuar në programin shkencor dhe zhvillim algoritmik në gjuhë si Python, MATLAB, C/C++, FORTRAN, ose platforma të ngjashme për simulim dhe analizë.
- Përvojë në analizë numerike dhe modelim fizik të përhapjes së valëve, kalibrim parametrash, ndërtim modelesh të integruara, si dhe aplikim të automatizimit dhe inteligjencës artificiale në përpunimin e të dhënave.
- Përfshirje në projekte kërkimore, publikime shkencore, konferenca dhe aktivitete ndërkombëtare.
- Statusi “Lektor” ose përmbushja e kushteve për këtë kategori vlerësohet si përparësi për një integrim të shpejtë dhe të plotë në strukturën kërkimore.
- Kualifikime shtesë dhe dokumentim i trajnimeve teknike, certifikimeve ose mobiliteteve akademike konsiderohen elemente mbështetëse në përzgjedhje.

II. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune pranë Institutit të Gjeoshkencave si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune “Kërkues Shkencor në fushën e Inxhinierimit dhe Optimizmit të Rrjetit Sizmologjik” në Departamentin e Sizmologjisë, në Institutin e Gjeoshkencave duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

I. Kriteret e përgjithshme:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar ciklin e studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave, ose ciklin e integruar të studimeve të larta, në fushën e Fizikës ose Inxhinierisë Fizike, me notë mesatare të përgjithshme të ponderuar jo më pak se 80/100, në përputhje me statutin e UPT.
2. Kandidati duhet të dëshmojë njohjen e një gjuhe të huaj, preferuar një nga gjuhët zyrtare të vendeve anëtare të OECD-së (si anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht etj.), në një nivel funksional për komunikim akademik e shkencor (jo më pak se niveli B2 sipas CEFR; preferohet C1 ose më lart).

II.Kriteret specifike:

1. Kandidati duhet të ketë eksperiencë të dokumentuar në projektim, modelim dhe optimizim të rrjeteve sizmologjike apo sensorike, si dhe në analizën e mbulimit hapësinor dhe vlerësimin e performancës së rrjetit në funksion të qëllimeve si zbulimi, lokalizimi dhe karakterizimi i burimeve sizmike.
2. Kërkohe nivel i avancuar në programim shkencor dhe përdorim të platformave numerike për simulim dhe analizë të dhënave në fushën e shkencave të tokës dhe sistemeve komplekse (p.sh. Python, MATLAB, R, C++).
3. Domosdoshmëri për këtë pozicion është përvoja me sisteme të integruara të monitorimit sizmik në kohë reale dhe përpunimit interaktiv të dhënave, me njohuri funksionale mbi një ose më shumë platforma të specializuara në këtë fushë.
4. Kandidati duhet të zotërojë njohuri mbi standardet dhe strukturat ndërkombëtare për të dhënat dhe metadatat sizmologjike (FDSN), përfshirë strukturën SDS, treguesit teknikë të rrjetit (SOH), arkitekturën funksionale dhe protokollin e komunikimit në rrjete monitorimi.
5. Vlerësohet aftësia për përdorimin dhe inegrimin e teknologjive bashkëkohore për menaxhimin dhe vizualizimin e të dhënave, përfshirë ndërfaqe rrjeti, sisteme metadata dhe instrumente për operacione të automatizuara dhe të shkallëzueshme.
6. Preferohet përvojë në menaxhimin e integruar të komponentëve harduerikë dhe softuerikë të rrjeteve sizmike, përfshirë konfigurimin, mirëmbajtjen, kalibrimin dhe kontrollin e cilësisë së të dhënave.
7. Angazhimi në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, publikime shkencore në revista të indeksuara, pjesëmarrje në konferenca apo seminare shkencore, si dhe përvoja në mësimdhënie ose mentorim.
8. Statusi “Lektor” ose përmbushja e kushteve për këtë kategori vlerësohet si përparësi për një integrim të shpejtë dhe të plotë në strukturën kërkimore.
9. Dokumentimi i kualifikimeve shtesë, trajnimeve teknike, certifikimeve apo mobiliteteve akademike konsiderohet një element mbështetës në përzgjedhjen përfundimtare.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **23.05.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.